



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 129/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2020, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërive “Desaret Company” sh.p.k dhe “Zdravo” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. REF-46295-12-17-2019, me objekt: “Ndertim i shkollës 9-vjeçare në fshatin Darëzezë”, me fond limit 32 100 663 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 20.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
- Ankimues:** “Kevin Konstruksion” sh.p.k
Rruga “Adem Jashari”, Nd.4, H.10, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Fier.
Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.12.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. REF-46295-12-17-2019, me objekt: “*Ndertim i shkollës 9-vjeçare në fshatin Darëzezë*”, me fond limit 32 100 663 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 20.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 07.02.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|----------------------------------|
| • “Desaret Company”sh.p.k | 24.144.467,00 lekë, kualifikuar |
| • “Zdravo” sh.p.k | 24.748.584,44 lekë, kualifikuar |
| • “Kevin Konstruksion” sh.p.k | 24.895.609,00 lekë, kualifikuar |
| • “Aurora Konstruksion” sh.p.k | 24.977.709,00 lekë, kualifikuar |
| • “Kola Invest” sh.p.k | 27.132.723,00 lekë, kualifikuar |
| • “Be-Is” sh.p.k | 27.323.860,00 lekë, kualifikuar |
| • “Leon Konstruksion” sh.p.k | 27.927.729,76 lekë, kualifikuar |
| • “Arkonstudio” sh.p.k | 28.955.490,00 lekë, kualifikuar |
| • “Llazo” sh.p.k | 34.554.793,08 lekë, skualifikuar |

II.3. Në datën 13.02.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e shoqërive “Desaret Company” sh.p.k dhe “Zdravo” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Kundershtojme kualifikimin e ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Desaret Company” Sh.p.k, duke pretenduar si me poshte:

II.1.1 Ne kriterin kualifikues pika 2.2 "Per kapacitetin ekonomik dhe financiar" eshte kerkuar "Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2019 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2019 per secilin operator)"

Shoqeria "Desaret Company" Sh.p.k ka provuar nepermjet ekstraktit historik te qendres kombetare te biznesit, se ka ushtruar aktivitet gjate vitin 2019 ne adresat si me poshte:

28.08.2019 Numri i ceshtjes: CN-316614-08-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes

Depozitimi i kerkeses, date 27.08.2019 per mbyllje adrese dytesore. Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: eshte Hequr Adresa: "Durres; DURRES; Ishem; LALEZ; Ndertimi i Rrjetit te Ujesjellsit te Gjiri i Lalzit, Durres;

2- 20/12/2019 Numri i ceshtjes: CN-435660-12-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes:

Depozitimi i kerkeses se administratorit, date 18.12.2019 ku eshte kerkuar: Mbyllja e nje adrese dytesore. Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: eshte Hequr Adresa: "Elbasan; LIBRAZH; Prrenjas; PRRENJAS; Ndertim Ujesjellesi Dritaj-Fanje-Karkavec, Bashkia Prrenjas;

3- Vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit Berat Corovode COROVODE Rikonstruksioni i Shkolles 9- Vjecare "Zylyftar Veleshnja", Corovode.

4- Zyra qendrore e shoqerise ne Shqiperi Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr 11, Rruga" Hysni Gerbolli", Pallati "Desaret", Prane Kryqit te Kuq, Kati perdhe.

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave vendore per adresat Durres, Librazhd, Prrenjas, Corovode dhe Tirane, kjo ne kundërshtim me kriterin kualifikues pika 2.2.

II.1.2 Ne kriterin kualifikues pika 2.3/2 germa a, eshte kerkuar: "Deklarate nga administratori i shoqerise per listen e stafit qe do te drejtoje punimet, ku te cilesohen detyra e secilit. "

Shoqeria "Desaret Company" Sh.p.k nuk ka paraqitur ne proceduren e prokurimit deklaraten e kerkuar ne kete kriter kualifikues.

II.1.3 *Ne kriterin kualifikues pika 2.3/3 autoriteti kontraktor ka kerkuar "Shoqeria duhet te kete ne stafin e saj specialiste ndertimi te certifikuar sipas profesioneve si me poshte: Teknike ndertimi 2 (dy), Karpentier 2 (dy), Murator 5 (pese), Suvatues 5 (pese), Punime durale 2(dy), Pllakashtrues 2 (dy), Bojaxhi 2 (dy), Elektriciste 2(dy), Hidraulik 2(dy). Per specialistet e kerkuar me siper (pika 23/3) te paraqiten diplome/deshmi/certifikate/ ose cdo dokument tjetër qe verteton*

kualifikimin e tij si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit)."

Ne daten 23.12.2019 autoriteti kontraktor ne pergjigje te kerkeses per sqarim ne lidhje me kriterin e mesiper ka sqaruar: "Per te vertetuar kualifikim e specialisteve te kerkuar ne piken 2.3.3 te kriterëve te vecanta te kualifikimit duhet te paraqitet diplome/deshmi/certifikate/ ose cdo dokument tjeter qe verteton kualifikimin e tij. Dokumenti i paraqitur per vertetimin e kualifikimit duhet te provoje kualifikimin e tij ne specialitetin e kerkuar sa me siper. Deshmia e kualifikimit te sigurimit teknik dokumenton qe subjekti eshte i trajnuar per te zbatuar rregullat e sigurimit teknik gjate punes por nuk perben nje dokument te vlefshem per te provuar kualifikimin arsimor profesional ne nje nje profesion te caktuar te kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit. Si rrjedhoje Deshmia e Kualifikimit te Sigurimit Teknik eshte nje dokument i cili nuk e permbush kete pike. "

Shoqeria "Desaret Company" Sh.p.k nuk ka paraqitur ne proceduren e prokurimit punonjes te kualifikuar per profesionet e mesiperme por ka paraqitur deshmi kualifikimi te sigurimit teknik ne kundershtrim me kriterin kualifikues dhe pergjigjes se kerkeses per sqarim te autoritetit kontraktor.

II.1.4 Ne kriterin kualifikues pika 2.3/4 autoriteti kontraktor ka kerkuar "Nje punesim mesatar per periudhen Janar 2019-Nentor 2019, i te pakten 50 personave me kohe te plote pune, duke perfshire stafin e perhershem;

Kjo pike dokumentohet me vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e 'Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .

Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)

Shoqeria "Desaret Company" Sh.p.k nuk ka vertetuar se disponon 50 punonjes me kohe te plote per periudhen e kerkuar, kjo ne kundershtrim me kriterin kualifikues dhe pergjigjes se kerkeses per sqarim te autoritetit kontraktor

II.1.5 Ne kriterin kualifikues pika 2.3/5 autoriteti kontraktor ka kerkuar "Disponimi ose mundesia e sigurt e disponimit ne paisjet/kapacitetet e meposhtme teknike, qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates

- Kamion veteshkarkues(kapacitet mbajtes nga 3.5 deri 7 ton) -cope 2(dy),
- Kamion veteshkarkues(kapacitet mbajtes nga 7 deri 15 ton) cope 1 (nje)
- Kamion vetshkarkues me vine (kapacitet mbajtes nga 3.5 deri 7 ton) cope 1 (nje)
- Autopompe betoni cope 1 (nje)
- Autobetoniere cope 2(dy)

Shenim: Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme) leje qarkullimi,certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, leje drejtimin per drejtuesin e mjetit te transportit, siguracionin e mjetit, foto te mjeteve, leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit. "

Ne kundershtim me kriterin kualifikues shoqeria "Desaret Company" Sh.p.k nuk ka paraqitur kamionat sipas kapaciteteve mbajtes te kerkuar.

Ne kundershtim me ligjin operatori ekonomik ka paraqitur mjete kamiona, autobetoniere dhe autompe betoni te mara me qera, te cilat nuk jane te pajisura me leje transporti mallrash per te trete dhe me qera.

II.1.6 *Ne kriterin kualifikues pika 2.3/6 autoriteti kontraktor ka kerkuar "Shoqeria duhet te jete e pajisur edhe me certifikatat e meposhtme:*

- *Sistemi menaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) (objekt i prokurimit)*
- *Sistemi menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001) ose ekuivalentja mete (ISO 45001-2018) (objekt i prokurimit)*
- *Sistemi i menaxhimit te integruar [PAS-99;2012] (objekt i prokurimit)."*

Ne kundershtim me kriterin kualifikues shoqeria "Desaret Company" Sh.p.k nuk ka paraqitur certifikata te ligjshme per sistemin e menaxhimit te integruar [PAS-99;2012] dhe ne perputhje me praktiken e ndjekur prej komisionit te prokurimit publik ne raste analoge.

II.2 *Kundershtojme kualifikimin e ofertes ekonomike te operatorit ekonomik "ZDRAVO" Sh.p.k me pretendimin se:*

II.2.1 *Ne kriterin kualifikues pika 2.2 "Per kapacitetin ekonomik dhe financiar" eshte kerkuar "Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2019 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2019 per secilin operator)"*

Shoqeria "ZDRAVO" Sh.p.k provuar nepermjet ekstraktit historik te qendren kombetare te biznesit, ka ushtruar aktivitet gjate vitin 2019 ne adresat si me poshte:

1- 15/04/2019 Numri i ceshtjes: CN-165134-04-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes:

Depozitimi i kerkeses, date 12.04.2019, ku eshte vendosur mbyllja e adreses dytesore. Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit: eshte Hequr Adresa: "Fier; LUSHNJE; Lushnje;; LUSHNJE; Lagjja Clirimi, Bulevardi i Palmave, rruga Hasan Cela, godine banimi me leje nr 29.;

2- Zyra qendrore e shoqerise ne Shqiperi Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Xhevdet Nepravishta, Ish godina e plastmasit.

3- Tirane Tirane TIRANE Qyteti i Nxenesve Rruga Hamdi Pepa, magazina nr 61. Fier

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave vendore per adresat Lushnje dhe Tirane, kjo ne kundershtim me kriterin kualifikues pika 2.2.

II.2.2 *Ne kriterin kualifikues pika 2.3/2 germa a, eshte kerkuar: "Deklarate nga administratori i shoqerise per listen e stafit qe do te drejtoje punimet, ku te cilesohen detyra e secilit."*

Shoqeria "ZDRAVO" Sh.p.k nuk ka paraqitur ne proceduren e prokurimit deklaraten e kerkuar ne kete kriter kualifikues.

II.2.3 Ne kriterin kualifikues pika 2.3/3 autoriteti kontraktor ka kerkuar "Shoqerta duhet te kete ne stafin e saj specialiste ndertimi te certifikuar sipas profesioneve si me poshte: Teknike ndertimi 2 (dy), Karpentier 2 (dy), Murator 5 (pese), Suvatues 5 (pese), Punime durale 2 (dy), Pllakashtrues 2 (dy), Bojaxhi 2 (dy), Elektriciste 2(dy), Hidraulik 2(dy). Per specialistet e kerkuar me siper (pika 2.3/3) te paraqiten diplome/deshmiltcertifikate/ ose cdo dokument tjeter qe verteton kualifikimin e tij si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit)."

Ne daten 23.12.2019 autoriteti kontraktor ne pergjigje te kerkeses per sqarim ne lidhje me kriterin e mesiper ka sqaruar: "Per te vertetuar kualifikim e specialisteve te kerkuar ne piken 2.3.3 te kriterëve te vecanta te kualifikimit duhet te paraqitet diplome/deshmi/certifikate/ ose cdo dokument tjeter qe verteton kualifikimin e tij. Dokumenti i paraqitur per vertetimin e kualifikimit duhet te provoje kualifikimin e tij ne specialitetin e kerkuar sa me siper. Deshmia e kualifikimit te sigurimit teknik dokumenton qe subjekti eshte i trajnuar per te zbatuar rregullat e sigurimit teknik gjate punes por nuk perben nje dokument te vlefshem per te provuar kualifikimin arsimor profesional ne nje nje profesion te caktuar te kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit. Si rrjedhoje Deshmia e Kualifikimit te Sigurimit Teknik eshte nje dokument i cili nuke permbush kete pike."

Shoqeria "ZDRAVO" Sh.p.k nuk ka paraqitur ne proceduren e prokurimit punonjes te kualifikuar per profesionet e mesiperme por ka paraqitur deshmi kualifikimi te sigurimit teknik ne kundershtrim me kriterin kualifikues dhe pergjigjes se kerkeses per sqarim te autoritetit kontraktor.

II.2.4 Ne kriterin kualifikues pika 2.3/4 autoriteti kontraktor ka kerkuar Nje punesim mesatar per periudhen Janar 2019-Nentor 2019, i te pakten 50 personave me kohe te plote pune, duke perfshire stafin e perhershem;

- Kjo pike dokumentohet me vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike.
- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)

Shoqeria "ZDRAVO" Sh.p.k nuk ka vertetuar se disponon 50 punonjes me kohe te plote per periudhen e kerkuar, kjo ne kundershtrim me kriterin kualifikues dhe pergjigjes se kerkeses per sqarim te autoritetit kontraktor.

II.2.5 Ne kriterin kualifikues pika 2.3/5 autoriteti kontraktor ka kerkuar "Disponimi ose mundesia e sigurt e disponimit ne paisjet/kapacitetet e meposhtme teknike, qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates

- Kamion veteshkarkuesikapacitet mbajtes nga 3.5 deri 7 ton cope 2(dy),
- Kamion veteshkarkuestkapacitet mbajtes nga 7 deri 15 ton cope 1 (nje),

- Kamion vetshkarkues me vine (kapacitet mbajtes nga 3.5 deri 7 ton) cope 1 (nje)
- Autopompe betoni cope 1 (nje)
- Autobetoniere cope 2(dy)

Shenim: Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme) leje qarkullimi, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, leje drejtimin per drejtuesin e mjetit te transportit, siguracionin e mjetit, Joto te mjeteve, leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit. "

Ne kundershtim me kriterin kualifikues shoqeria "ZDRAVO" Sh.p.k nuk ka paraqitur kamionat sipas kapaciteteve mbajtes te kerkuar,

Ne kundershtim me ligjin operatori ekonomik ka paraqitur mjete kamiona, autobetoniere dhe autopompe betoni te mara meqera, te cilat nuk jane te pajisura me leje transporti mallrash per te trete dhe me qera.

II.2.6 *Ne kriterin kualifikues pika 2.3/6 autoriteti kontraktor ka kerkuar "Shoqeria duhet te e me certifikatat e meposhtme:*

- *Sistemi menaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) (objekt i prokurimit)*
- *Sistemi menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001) ose ekuivalentja mete (ISO 45001-2018) (objekt i prokurimit)*
- *Sistemi i menaxhimit te integruar [PAS-99;2012] (objekt i prokurimit)."*

Ne kundershtim me kriterin kualifikues shoqeria "ZDRAVO" Sh.p.k nuk ka paraqitur certifikata te ligjshme per sistemin e menaxhimit te integruar [PAS-99;2012] dhe ne perputhje me praktiken e ndjekur prej komisionit te prokurimit publik ne raste analoge."

II.4. NËPËRMJET SHKRESËS NR. 1224/2 PROT., DATË 14.02.2020 AUTORITETI KONTRAKTOR I KA KTHYER PËRGJIGJE ANKIMUESIT DUKE E REFUZUAR ANKESËN SI VIJON:

"Ne pergjigje te ankeses tuaj protokolluar prane Bashkise Fier me nr.1224 prot., date 13.02.2020, per tenderin me objekt "Ndertim i shkollës 9-vjecare ne fshatin Darezeze", si dhe bazuar ne nenin 63 te ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, ne V.K.M. nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, neni 78, pika 5, ne te cilin theksohet:

"Gjate procedures se prokurimit, ankesat kunder vendimeve te autoritetit kontraktor duhet te dorezohen fillimisht prane autoritetit kontraktor brenda 7 diteve nga dita e neserme e punes, nga data kur ankimesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per kete shkelje te ligjit", Titullari i Autoritetit Kontraktor menjehere pasi u njoftua ne lidhje me ankesen tuaj nxorri urdherin e pezullimit te vazhdimit te procedures me nr.1177II prot., dt.12.02.2020, si dhe ne te njejten date urdheroi Komisionin per Shqyrtimin e Ankeses, te perbere nga zyrtare qe nuk kane . marre pjese ne vendimmarrjen per te cilen eshte paraqitur ankesa, te njihet me ankesen e paraqitur ne Bashkine Fier nga Operatori Juaj Ekonomik dhe te dale me nje vendim per te. Komisioni per Shqyrtimin e Ankeses pasi shqyrtoi te gjithe dokumentat e vena ne dispozicion nga

Njesia e Prokurimit si: dokumentat e hedhura ne sistem prej operatoreve ekonomike, DST per kete procedure e cdo dokument tjeter te nevojshem te dosjes se tenderit, vendosi mos pranimin e ankeses.

Referuar formularit te ankeses se bere nga operatori ekonomik KEVIN KONSTRUKSION ku ngrihen pretendime ne lidhje me kualifikimin e operatoreve te tjere ekonomik, pjesearres ne gare "DESARET COMPANY" shpk i renditur i pari ne klasifikim sipas ofertes se paraqitur dhe operatorit ekonomik BOE ZDRA VO shpk & COLOMBO shpk, i renditur i dyti ne kim sipas ofertes se paraqitur, ne proceduren e prokurimit me objekt "Ndertim i shkollës 9-vjecare ne fshatin Darezeze ", komisioni i ngritur per shqyrtimin e kesaj ankesë arsyeton si me vijon:

1. Ne lidhje me pretendimin tuaj se shoqeria "DESARET COMPANY" shpk nuk ka plotesuar piken 2.2 'Per kapacitetin ekonomik dhe financiar ', sa i takon kriterit "Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2019 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2019 per secilin operator)", pasi "nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave vendore per adresat Durres, Librazhd, Prrenjas, Corovode dhe Tirane". Ky pretendim i subjektit ankimues nuk eshte i vertete. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik "DESARET COMPANY" shpk, ne sistemin elektronik te prokurimeve, per kete tender, rezulton se ky OE ka paraqitur vertetimet per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2019, ne te gjitha njesite vendore ku ushtron aktivitet sipas ekstraktit te QKB. Konkretisht ky OE ka paraqitur, vertetim m.158 date 27.05.2019 nga Bashkia Durres, vertetim date 28.06.2019 nga Bashkia Prrenjas, vertetim m.2431 date 09.08.2019 nga Bashkia Skrapar (Corovode), si dhe vertetim me vule elektronike date 27.06.2019 nga Bashkia Tirane.

Sa i takon pretendimit te subjektit ankimues qe subjekti "DESARET COMPANY" duhet te paraqiste vertetim per shlyerjen e taksave vendore nga Bashkia Librazhd, ky pretendim eshte i gabuar, pasi subjekti "DESARET COMPANY", nuk ushtron aktivitet ne Bashkine Librazhd, por aktivitetin sipas Numrit te ceshtjes: CN-435660-12-19, ai e ka ushtruar ne Bashkine Prrenjas dhe jo ne Bashkine Librazhd.

Ne kete kuptim, subjekti "DESARET COMPANY" shpk duke qene se ka paraqitur per cdo vend te ushtrimit te aktivitetit, sipas ekstraktit te QKB, vertetime per shlyerjen e taksave vendore nga te gjitha njesite vendore, e ka plotesuar rregullisht kriterin e percaktuar ne piken 2.2 'Per kapacitetin ekonomik dhe financiar ', te DST

Per kete arsye pretendimi i subjektit ankimues per kete pike nuk qendron,

2. Ne lidhje me pretendimin tuaj se shoqeria "DESARET COMPANY" shpk nuk ka paraqitur deklaraten e percaktuar ne piken 2.3/2, germa 'd' (dhe jo 'a', sic pretendohet ne ankesë) ku kerkohet: "Deklarate nga administratori i shoqerise per listen e stafit qe do te drejtoje punimet, ku te cilesohen detyra e secilit", sqarojme se ky pretendim i subjektit ankimues nuk eshte i vertete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik "DESARET COMPANY" shpk, ne sistemin elektronik te prokurimeve, rezulton se ky i fundit e ka paraqitur deklaraten e kerkuar ne piken 2.3/2, germa 'd', te kerkesave per kualifikim te DST. Pretendimi per mungesen e ketij dokumenti eshte absurd dhe nuk bazohet ne asnje te dhene apo tregues konkret.

Per kete arsye pretendimi i subjektit ankimes per kete pike nuk qendron.

3. Ne lidhje me pretendimin tuaj se shoqeria "DESARET COMPANY" shpk "nuk ka paraqitur ne proceduren e prokurimit punonjes te kualifikuar per profesionet e mesiperme, por ka paraqitur deshmi kualifikimi te sigurimit teknik ne kundershtim me kriterin kualifikues", te percaktuar ne piken 2.3/3, te kerkesave per kualifikim te DST, sqarojme se ky pretendim nuk eshte i vertete.

Ne paragrafin e fundit te pikes 2.3/3, te kerkesave per kualifikim te DST, kerkohet qe: "Per specialistet e kerkuar me siper (pika 2. 3/3) te paraqiten diplome I deshmi I certifikate/ ose cdo dokument tjeter qe verteton kualifikimin e tij si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit) ".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik "DESARET COMPANY" shpk, ne sistemin elektronik te prokurimeve, rezulton se ky i fundit, ndryshe nga cfare pretendohet ne ankese, ka paraqitur certifikata te rregullta te formimit profesional, per te gjitha profesionet e kerkuara ne piken 2.3/3 (I teknike ndertimi 2 (dy); Karpentier 2(dy); Murator 5 (pese); Suvatues 5 (pese); Punime durale 2 (dy); Pllakashtrues 2 (dy) .Bojaxhi 2 (dy); Elektriciste 2(dy); Hidraulike 2(dy); Ekspert zjarrfikes te certifikuar (I person). Te gjitha keto certifikata jane leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Tirane (Ministria e Financave dhe Ekonomise), Drejtoria e PMZSH, institucione kompetente shteterore, etj., si dhe jane me nr.amze apo me nr.regjistrimi te rregullta. Per te gjitha profesionet e kerkuar, subjekti ka paraqitur edhe kontratat e punes te vlefshme, sic kerkohet ne DST. Pervet sa me siper, rezulton se subjekti _ te gjitha profesionet e kerkuara, i ka shoqeruar edhe me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik, sipas profesioneve. Pra, nuk eshte e vertete qe subjekti ka paraqitur vetem deshmi kualifikimi te sigurimit teknik, por ai ka paraqitur edhe certifikata te rregullta te formimit profesional dhe kontratat e punes, per secilin nga profesionet e kerkuara dhe ne numrin e kerkuar, duke plotesuar kete kriteri kualifikimi.

Per kete arsye pretendimi i subjektit ankimes per kete pike nuk qendron.

4. Ne lidhje me pretendimin tuaj se shoqeria "DESARET COMPANY" shpk "nuk: ka vertetuar se disponon 50 punonjes me kohe te plate per periudhen e kerkuar, kjo ne kundershtim me kriterin kualifikues ", te percaktuar ne piken 2.3/4, te kerkesave per kualifikim te DST, sqarojme se ky pretendim nuk eshte i vertete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik "DESARET COMPANY" shpk, ne sistemin elektronik te prokurimeve, rezulton se ky i fundit, ndryshe nga cfare pretendohet ne ankese, ka paraqitur vertetimin me vule elektronike nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane Nr.T01720544 date 17.01.2020 per kontributet e sigurimeve shoqerore per nje numer punonjesish prej afro 3 here apo 4 here me shume se numri i kerkuar ne DST.

Per me teper, vertetimi i sipercituar eshte shoqeruar edhe me listepagesat per cdo muaj te periudhes sc kerkuar (per periudhen Janar 2019-Nentor 2019), ne te cilat dokumentohet punesimi me kohe te plote i punonjesve te kerkuar dhe stafit te perhershem.

Per kete arsye pretendimi i subjektit ankimes per kete pike nuk qendron.

5. Ne lidhje me pretendimin tuaj se shoqeria "DESARET COMPANY" shpk "nuk ka paraqitur kamionat sipas kapaciteteve mbajtes te kerkuar dhe se ka paraqitur mjete kamiona autobetoniere

dhe autopompe betoni me qera, te cilat nuk jane te pajisura me leje transporti mallrash per te trete", te percaktuar ne piken 2.3/5, te kerkesave per kualifikim te DST, ky pretendim nuk eshte i vertete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik "DESARET COMPANY" shpk, ne sistemin elektronik te prokurimeve, rezulton se ky i fundit ka paraqitur Shtojcen 10 "MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE", se bashku me te gjitha dokumentacionin perkates, si per mjetet ne pronesi ashtu edhe per mjetet me qira, te cilat pas verifikimit rezultojne te rregullta, dhe kamionat rezultojne sipas kapaciteteve mbajtes te kerkuar ne DST.

Bazuar ne piken e sipercituar, AK Bashkia Pier ka kerkuar ne DST gjithsej 4 (kater) kamion veteshkarkues. Per kete pike subjekti "DESARET COMPANY" shpk, referuar Shtojcen 10 "MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE", por edhe dokumentacionit perkates se ketyre mjeteve, ka paraqitur 1 (nje) kamion veteshkarkues me vinc ne pronesi dhe 3 (tre) kamion veteshkarkues jane marre me qira sipas kontratave noteriale te qirase. Bashkengjitur dokumentacionit per te 4 (kater) kamionat veteshkarkues, jane paraqitur edhe Licensat apo Certifikatat e Transportit te Mallrave, te vlefshme dhe te leshuara nga organet kompetente.

Ne rastin e kamionit veteshkarkues me vinc 1 (nje) cope, ne pronesi te subjektit "DESARET COMPANY" shpk, eshte paraqitur Certificate per transportin e mallrave per llogari te vet brenda vendit, ndersa ne rastet e kamionave veteshkarkues te marre me qira, secili kamion eshte shoqeruar edhe me Certificate/License per transportin e mallrave per te trete dhe me qira brenda vendit.

Duke qene se kriteret per kualifikim, por edhe rregullat e prokurimit kane percaktuar se lejohet qe makinerite dhe Pajisjet te jene ne pronesi ose me qira, si dhe duke qene se cdo mjet i marre me qira eshte shoqeruar edhe Certificate/License per transportin e mallrave per te trete dhe me qira brenda vendit, e cila patjeter qe ne zbatim te legjislacionit ne fuqi, leshohet ne emer te pronarit te mjetit, por qe ky i fundit ka te drejte ta vendose ne dispozicion per te trete ose me qira, sipas Licenses, atehere subjekti "DESARET COMPANY" shpk ka plotesuar kriterin e percaktuar ne piken 2.3/5 te Kerkesave per Kualifikim te DST

Per kete arsye pretendimi i subjektit ankimues per kete pike nuk qendron.

6. Ne lidhje me pretendimin tuaj se shoqeria "DESARET COMPANY" shpk, "nuk ka paraqitur certifikata te ligjshme per sistemin e menaxhimit te integruar [PAS-99;2012]", te percaktuar ne piken 2.3/6, te kerkesave per kualifikim te DST, ky pretendim nuk eshte i vertete. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik "DESARET COMPANY" shpk, ne sistemin elektronik te prokurimeve, rezulton se ky i fundit ka paraqitur te gjitha certifikatat sic kerkohen ne piken 2.3/6, te kerkesave per kualifikim te DST, dhe per me teper ka paraqitur certifikaten e vlefshme per sistemin e menaxhimit te integruar [PAS-99;2012], me nr.regjistrimi AQS/PAS/24902018, leshuar ne emer te "DESARET COMPANY" shpk, per objektin e prokurimit te kerkuar.

Per kete arsye pretendimi i subjektit ankimues per kete pike nuk qendron.

7. Ne lidhje me pretendimet tuaja per kundershtimin e kualifikimit edhe te shoqerise se renditur e dyta ne klasifikim "Zdravo" sh.p.k, duke qene se ato jane plotesisht te njejta me pretendimet edhe per shoqerine e renditur e para ne klasifikim "Desart Company" sh.p.j dhe duke qene se vlejne te njejtat argumenta se pari ben me dije se nga shqyrtimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik "ZDRA VO" shpk, ne sistemin elektronik te prokurimeve, rezulton se ky subjekt ka

paraqitur dokumentacion te rregullt dhe se pretendimet e ankimuesit nuk jane te verteta, nuk bazohen ne asnje fakt apo indicie, pretendimet e ngritura edhe per OE "ZDRAVO" shpk nuk qendrojne, dhe ne keto kushte ankesa edhe per kete OE nuk pranohet. Per ekonomi te procedures, edhe pas shqyrtimit te kesaj ankese, pozita juridike e subjekteve nuk ndryshon, dhe ne keto kushte subjekti ankimues (KEVIN KONSTRUKSION shpk), edhe pas shqyrtimit te kesaj ankese, renditet i treti ne klasifikimin e ofertave.

Operatori ekonomik i cili paraqet nje ankese te tille, ka detyrimin qe te provoje pretendimin e tij mbi shkeljen/t e pretenduar/a, pra te evidentojte qarte dhe sakte se ku e bazon pretendimin e tij per mospermbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatoreve ekonomike te tjere.

Ky eshte edhe qendrimi ligjor dhe i konsoliduar qe ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), ne trajtimin qe ky i fundit i ka bere ceshtjeve te ngjashme, kur subjekti ankimues ankohet per operatoren e tjere konkurrente.

Duke qene se sic eshte evidente AK Bashkia Fier, nepermjet nje shqyrtimi objektiv dhe profesional te seciles oferte pjesmarrese ne kete procedure prokurimi, ka kualifikuar subjektet pjesmarrese sipas dokumentacionit te rregullt te secilit dhe ka bere klasifikimin e ofertave, bazuar ne renditjen e tyre sipas ofertes me te ulet, AK Bashkia Fier, konstaton me keqardhje se ankesa e subjektit KEVIN KONSTRUKSION shpk, gjykuar nga permbajtja e saj, eshte nje ankese e pabazuar ne asnje prove, fakte apo indicie konkrete. Fakti qe subjekti ankimues i cili eshte i treti ne renditje, ngre te njejtat pretendime per te dy subjektet e renditur i pari dhe i dyti ne klasifikimin e ofertave, pa asnje analize apo reference konkrete dhe te qenesishme ne fakte reale, por thjesht pretendon se mungojne dokumenta te caktuar, kur dokumentat jane ne sistemin elektronik te prokurimeve, tregon per nje tejkalim abuziv te te drejtave qe i jep ligji cdo OE per tu ankuar, duke perbere ne menyre jo te drejte dhe ligjore nje pengese serioze per vijimin normal te procedurave, si dhe duke i shkaktuar dem autoritetit kontraktor.

AK Bashkia Fier shpreh shqetesimin e saj per kete fenomen dhe bazuar ne Ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, do te referojte raste te tilla edhe ne institucionin e Agjencise se Prokurimit Publik, pasi gjykojme se nepermjet ankesave te tilla haptazi ne tejkalim te ligjit, te pabazuara ne asnje fakt, llogjik, apo prove shkresore, cenohet rende interesi publik dhe mbarevajtja e nje procesi normal prokurimi [...]."

II.5. Në datën 20.02.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 26.02.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 212/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1784 prot., datë 24.02.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k mbi kualifikimin e shoqërive “Desaret Company” sh.p.k dhe “Zdravo” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. REF-46295-12-17-2019, me objekt: “*Ndertim i shkolles 9-vjeçare në fshatin Darëzezë*”, me fond limit 32 100 663 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 20.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.1.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k ankimues nuk parashtroi fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për pjesën më të madhe të kriterëve në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotësojnë kriteret e vendosura në DST secili nga shoqëritë “Desaret Company” sh.p.k dhe “Zdravo” sh.p.k të kualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

III.1.2. Akoma më tej, referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:*

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.1.3. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë.

Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljet e pretenduara, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku i bazon pretendimet e tij për mospërmbushjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë.

Theksojmë se mospërmbushja e kriterëve apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krahasim të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatorit pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përsë vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

III.1.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k për shoqëritë “Desaret Company” sh.p.k dhe “Zdravo” sh.p.k nuk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me me Nr. REF-46295-12-17-2019, me objekt: “*Ndertim i shkolles 9-vjeçare në fshatin Darëzezë*”, me fond limit 32 100 663 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 20.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 212 Protokolli

Datë 20.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha